



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN			
PRANUAR MË: PRIMLJENË DANA: 05.08.2026			
NUMËRIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT SR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS BR. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG
05-026/04-37733			



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Nenit 8 të Rregullores mbi kriteret, standartet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve nr. MF04/2017 si dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr. 110-78095 i datës 24.12.2021, Drejtori i DKRS shpallë:

**NJOFTIM PUBLIK
PËR DORËZIMIN E PROPOZIMEVE PËR ANËTARË NË KOMISIONIN VLERËSUES
PËR ORGANIZIMIN E THIRRJES PUBLIKE “SPORTI-MUNDËSI PËR TË GJITHË NË
KOMUNËN E LIPJANIT”**

Njoftohen përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile se mund t'i dërgojnë propozimet e tyre për plotësimin e Komisionit Vlerësues i cili do të formohet me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të financimit të projekteve të OJQ-ve që do të aplikojnë sipas thirrjes publike për aplikim me Nr.05-453/01-34248 të datës: 23.07.2026.

Komisioni do të formohet me qëllim të financimit të projekteve të klubeve sportive në fushën e sportit për kategorinë e seniorëve për vitin 2026, ku do të plotësohet me:

- Një përfaqësues nga shoqëria civile në cilësinë e ekspertit.
- Një përfaqësues nga OJQ-të.

Propozimet tuaja do të jenë të mirëpritura dhe duhet t'i drejtohen Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të njëjtat të dorëzohen në ndërtesën e Komunës kati I në Qendrën për shërbime me qytetar sportelet nr. 1 dhe 2, jo më vonë se data **13.08.2026**.